



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Viti akademik 2022-2023

TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof.Asoc. Ogerta Koruti, Dr. Daniela Hasa;

Ngarkesa:

6 Kredite (= 60 orë)

3 Kredite Leksione - (= 30 orë);

3 Kredite seminare - (= 30 orë);

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: I/2

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor/Mësuesi - Gjuhë Angleze

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: ogerta.koruti@unitir.edu.al;
daniela.hasa@unitir.edu.al

Kodi i Etikës:

Në këtë lëndë ndiqet dhe zbatohet Kodi i Etikës së Universitetit.

Procesi mësimor do zhvillohet duke patur në qendër respektimin e secilit student dhe ofrimin të mundësive për të përfitur nga koha në procesin mësimor.

Mësimi dhe vlerësimi do zhvillohen sipas planit të miratuar nga departamenti.

Studentëve do u jepet mundësia që të përfshihen sa më shumë që të jetë e mundur në diskutimet që zhvillohen në kuadër të lëndës dhe për më tepër do të jenë të lirë që të ngrejnë pyetje apo të sqarojnë çdo koncept gjuhësor.

Mësimi dhe trajtimi i studentëve në mësim do zhvillohet në mënyrë objektive dhe të paanshme.

Do zbatohet me përpikmëri politika e universitetit për ndershmërinë akademike. Duke pasur parasysh edhe natyrën e lëndës, studentët do të njihen edhe me etiketën në internet (netiquette) me qëllim që të sigurohet një komunikim sa më efikas ndërmjet tyre dhe pedagogut. Gjithashtu, do të theksohet edhe rëndësia e ruajtjes së privatësisë dhe respektimit të informacionit personal që do të ndahet gjatë procesit mësimor.

Do respektohet etiketa e punës online, për aq kohë sa do të jetë e nevojshme.

Plagjiatura: Do zbatohet politika e departamentit për plagjaturën. Rastet e pandershmërisë akademike dhe plagjaturës do trajtohen sipas rregullave të Fakultetit.

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për integrimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze në shkollat e mesme në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës.

Kjo lëndë do të zhvillohet duke pasur në vëmendje rolin e teknologjive, se si ajo i vë bazat për prurjen e risive në metodat e mësimdhënies së gjuhës angleze por edhe më gjerë.

Kryesisht lënda përqëndrohet në ndikimin e madh që ka përdorimi i teknologjisë në klasë, në mënyrën e organizimit të orëve mësimore me anë të mjeteve teknologjike. Gjithashtu studentët inkurajohen të rishikojnë planet mësimore, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pjesëmarrjen, sjelljen dhe motivimin e nxënësve. Lënda i njeh studentët, gjithashtu, me materialet që do përdoren gjatë semestrit dhe se si do të përdoren ato në procesin e mësimin të gjuhës së huaj.

Vëmendja përqëndrohet në përdorimin e aplikacioneve të ndryshme, programeve kompjuterike, mjeteve teknologjike, mënyrës së gjetjes së materialeve online, ndërtimin e faqeve të ndryshme si wikis, blogs, google classroom etj. Lënda zhvillohet me leksione dhe seminare për një aftësim më të mirë praktik të studentëve dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore të tyre.

Ky kurs synon

- të njohë studentët me teknologjitë e reja në mësimdhënie dhe mënyrë e integritit të tyre në një orë mësimore.
- të aftësojë studentët për përdorimin e mjeteve teknologjike, aplikacioneve, programeve dhe mjeteve të tjera vizuale.

Pasi studenti njihet me burime të ndryshme të informacionit dhe teknologjisë si dhe programet specifike të hartuara për mësimdhënien e gjuhës angleze, atij i kërkohet që të demonstrojë informacionin e përfutur nëpërmjet përmbushjes së detyrave që i ngarkohen nga pedagogët.

Studenti në fund të kësaj lënde duhet të:

- Jetë në gjendje të kërkojë në internet e të mbledhë materialet të ndryshme autentike në ndihmë të një ore mësimi
- Përdorë një sërë mediash e metodash gjatë mësimdhënies
- Jetë në gjendje të hapë një faqe interneti
- Komunikojë me studentët e tjerë dhe pedagogun nëpërmjet rrjeteve të hapura, të jetë aktiv në forumet e organizuara dhe të ofrojë feedback-un e tij nëpërmjet tyre